



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:109058

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05747335

C.nr.1310/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Zyra e Avokatëve “..... &” Sh.P.K., av. L.M. dhe T.H. që të dy nga Prishtina, kundër të paditurve: V.Z. dhe K.Z. që të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. N.K. nga Prizreni, për shkak të anulimit të kontratës së shitblerjes dhe lirimit të paluajtshmërisë, vlera e kontestit mbi 100,000.00 euro, më datë 29.05.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. NDËRPRITET gjykimi në këtë çështje juridike kontestimore, në kuptim të nenit 278 par. 2 të Ligjit për procedurën kontestimore (LPK).

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj pasi të përfundojë procedura në formë të prerë tek gjykata ose te organi tjetër kompetent – Prokuroria Themelore në Prizren.

A r s y e t i m

Paditësi- propozuesi i sigurimit I.K. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, av. T.H. nga Prishtina, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurve-kundërshtarëve të sigurimit: V.Z. dhe K.Z. që të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson av. N.K. nga Prizreni, për shkak të anulimit të kontratës së shitblerjes dhe lirimit të paluajtshmërisë, vlera e kontestit mbi 100,000.00 euro.

Gjykata, me qëllim të mbarëvajtjes së procesit kontestimor, më datë 29.11.2023 ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, në të cilën kanë prezantuar paditësi I.K. të autorizuarit e tij av. L.M. dhe T.H. i padituri V.Z. dhe i autorizuari i tij av. N.K.

Gjatë kësaj seancën gjyqësore, i autorizuari i paditësit, av. T.H. në seancën e shqyrtimit kryesor më datë 29.11.2023, ka deklaruar se nga shikimi i kontratës mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e datës 11.11.2009, ku si blerës është i padituri V.Z. dhe shitës paditësi I.K. Nga kjo kontratë, shihet se i padituri V.Z. si blerës, jep shuma të ndryshme si 100,000.00 euro, toka e kështu me radhë. Ndërsa, në anën tjetër kemi kontratën mbi shitblerjen e paluajtshmërisë e datës 31.05.2011, ku i padituri V.Z. paraqitet si përfaqësues i shitësit- paditësit I.K. ndërsa i padituri i dytë K.Z. paraqitet si blerës, ku ky i fundit ia ka paguar paditësit shumën prej 419,902.00 euro. Andaj, përmes këtyre provave ka theksuar se ekziston dyshimi se ka elemente të veprës penale legalizimi i përmbajtjes së rreme, detyrimi dhe fajdeja, sipas dispozitave ligjore të KPRK-së. Prandaj, ka kërkuar që gjykata përmes një shënimi zyrtar t'i drejtohet organeve kompetente të ndjekjes, në mënyrë që të hetohen dhe vlerësohen këto dyshime për vepra penale.

Numri i lëndës: 2020:109058
Datë: 29.05.2024
Numri i dokumentit: 05747335

Pas deklaramit të të autorizuarit të paditësit, gjykata konstaton se është paraqitur një rrethanë e re, përkatësisht dyshimi për kryerjen e veprës penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, andaj duke u bazuar në nenin 278 par. 2 të LPK-së ku parashihet që “gjykata mund ta caktojë ndërprerjen e gjykimit në qoftë se vendimi mbi kërkesëpadinë varet nga fakti nëse është kryer delikti ekonomik apo vepra penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, kush është kryerësi dhe nëse ai është i përgjegjshëm, e sidomos kur paraqitet dyshimi se dëshmitari ose eksperti ka dhënë deklaratë të rreme, apo se dokumenti i përdorur si mjet provues është i rremë”, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e ndërprerë gjykimin.

Gjykata pas analizimit dhe vlerësimit të të lartcekurave, erdhi ne përfundim se procedura në këtë çështje juridike duhet të ndërpritet, pasi janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 278 par. 2 lidhur me nenin 280 par. 3 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.1310/2020 më datë 29.05.2024

Gjyqtari
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate Themelore.